

**GJYKATA E QARKUT E
GJILANIT**

30 qershor 2011

AC.nr.195/2010

GJYKATA E QARKUT E GJILANIT përmes trupit gjykues përbërë nga Gjyqtarja e lëndëve civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA si kryetare e trupit gjykues, Gjyqtarit vendor MUHAMET REXHA dhe Gjyqtarit vendor ABDULLAH AHMETI, si anëtar të trupit gjykues,

Ne lëndën civile të paditësit FARI FETAHU nga VITIA me përfaqësues të autorizuar Avokatin SHEMSEDIN PIRAJ nga GJILANI kundër të paditurve MIRVETE SALIHU-FETAHU nga VITIA, tani duke jetuar jashtë vendit në një adresë të panjohur dhe me përfaqësues të autorizuar Avokatin SAHIT MUSA nga VITIA, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU, dhe ARIF FETAHU, të gjithë nga VITIA, të tre duke jetuar jashtë vendit në një adresë të panjohur, ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU dhe BUJARE FETAHU, të tre nga fshati DROBESH, Komuna e VITISË,

Pas padisë për vërtetimin e pronësisë sipas Nenit 254, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurë Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/2008) ("LPK"),

Pasi që është vendosur sipas ankesës së FARI FETAHUT të ushtruar kundër Aktgjykimit C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 6 prill 2010, në procedurë të shkallës së dytë sipas Nenit 185 - 205 LPK,

Pas këshillimit dhe votimit lidhur me këtë ankesë në seancën e trupit gjykues, sipas Nenit 190, paragrafi 1, fjalia e parë të LPK, të mbajtur me 30 qershor 2011,

Përmes kësaj e sipas Nenit 195, paragrafi 1, pika c) dhe Nenit 198, paragrafi 2 LPK merr këtë:

A K T V E N D I M

APPROVOHET si e bazuar ankesa e FARI FETAHUT nga VITIA me përfaqësues të autorizuar- Avokatin SHEMSEDIN PIRAJ nga GJILANI dhe **ANULOHET** Aktgjykimi C.nr.350/2009 i Gjykatës Komunale të VITISË, i datës 6 prill 2010, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

ARSYETIMI

I. Historiati procedural

1. Me Aktgjykimin C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 6 prill 2010, është refuzuar padia e paditësit FARI FETAHUT ushtruar kundër të paditurve MIRVETE SALIHU-FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU, ARIF FETAHU, ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU, dhe BUJARE FETAHU

për vërtetimin e pronësisë në pjesë ideale prej 1/2 të ngastrës kadastrale nr.1474/4 sipas kopjes së planit nr.3/11, në vendin e quajtur "RASULA", me kulturë – arë e klasës së III-të, në sipërfaqe prej 0.20.00 ha, ZK DROBESH, regjistruar në Fletën Poseduese të re në emër të të ndjerit ARIF FETAHU, të trashëguar nga të paditurit sipas Aktvendimeve mbi Trashëgiminë T.nr.50/2000, të datës 12 dhjetor 2001 dhe 7 gusht 2002 në pjesë ideale prej 1/7.

2. Me 28 prill 2010, është ushtruar një ankesë nga FARI FETAHU përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ nga GJILANI duke e atakuar në tërësi Aktgjykimin C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 6 prill 2010 për shkak të *shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore* sipas Nenit 182, paragrafi 2, pikat k) dhe n) LPK, *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike* sipas Nenit 183 LCP dhe *zbatimit të gabuar të drejtës materiale* sipas Nenit 184 LPK. Kërkesa e ankuesit drejtuar Gjykatës së shkallës së dytë ishte që të ndryshohet Aktgjykimi i C.nr.350/09 i Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 20 prill 2010 me aprovim të padisë ose të anulohet Aktgjykimi duke ia kthyer lëndën Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

3. Sipas Nenit 187, paragrafi 2 LPK me 4 maj 2010 është dorëzuar një përgjigje nga ana e të paditurës MIRVETE SALIHU-FETAHU duke i kundërshtuar të gjitha thëniet e theksuara në ankesë dhe duke kërkuar vërtetimin e Aktgjykimit të atakuar të shkallës së parë.

4. Me që ankesa nuk është administruar sipas rregullit nga Gjykata e shkallës së parë, kjo Gjykatë e shkallës së dytë, sipas Nenit 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK, kopjet e saj i ka dorëzuar me 21 qershor 2011 të paditurve MIRVETE SALIHU-FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU, ARIF FETAHU, ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU dhe BUJARE FETAHU për tu përgjigjur brenda periudhës prej 7 ditëve.

5. Përgjigja nga e paditura MIRVETE SALIHU-FETAHU, e datës 4 maj 2010 është dorëzuar nga kjo Gjykatë e shkallës së dytë në pajtim me Nenin 187, paragrafi 2 LPK ankuesit FARI FETAHU me 21 qershor 2011, i cili me 24 qershor 2011, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ nga GJILANI ushtroi parashtresë duke e kundërshtuar atë si të vonuar dhe të pabazuar.

II. Kompetencat e trupit gjykues të Gjykatës së qarkut të GJILANIT

6. Kjo lëndë civile e shkallës së dytë- AC.nr.195/10 të GjQ të GJILANIT- është përzgjedhur sipas Nenit 5, paragrafi 1, pika c) të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ("Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat") me një Aktvendim të Gjyqtarit të EULEX-it, i datës 16 dhjetor 2010. Seanca dëgjimore sipas Nenit 5, paragrafi 7, fjalia e parë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, është mbajtur me 23 shkurt 2011 nga Gjyqtari i EULEX-it i emëruar si i Deleguar i Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it në pajtim me Vendimin ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2230/mgc/11, të datës 28 janar 2011. Gjyqtar i njëjtë i EULEX-it

bazuar në Nenin 5, paragrafi 7, fjalia e dytë të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, morri një Aktvendim, të datës 24 shkurt 2011, për caktimin e lëndës trupit tre-anëtarësh gjykues të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT sipas Nenit 5, paragrafët 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, me një Gjyqtar të EULEX-it si Kryetar të trupit gjykues dhe dy gjyqtarë vendor si anëtarë të trupit gjykues të emëruar pas Vendimit mbi përjashtim ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2298/mgc/11 të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 3 mars 2011 sipas Nenit 5, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat me Vendimin Agj.nr.40/11 të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 9 mars 2011.

7. Duke qenë i përbërë sipas ligjit dhe në pajtim me kriteret specifike të Nenit 5, paragrafët 1, 2, 4, 5 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, ky trup gjykues tre-anëtarësh i Gjykatës së Qarkut të GJILANIT është i autorizuar të gjykoj lëndën AC.nr.195/10 bazuar në kompetencat vepruese të Gjykatës së shkallës së dytë sipas dispozitave të përgjithshme të Nenit 15, paragrafi 2 dhe Nenit 176, paragrafi 3 LPK.

III. Lejueshmëria e ankesës dhe procedura e shkallës së dytë

8. Nuk ekzistojnë pengesa procedurale për të vendosur lidhur me ankesën. *Së pari*, ushtrimi i saj nuk është i ndaluar por është saktësisht i paraparë sipas Nenit 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK me që vendimi i atakuar gjyqësor është Aktgjykim meritore sipas padisë i shkallës së parë. *Së dyti*, ankesa nuk është e vonuar sipas Nenit 186, paragrafi 2 LPK. Aktgjykimi C.nr.350/2009 i Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 6 prill 2010, ishte dorëzuar sipas rregullit FARI FETAHUT me 14 prill 2010. Ankesa e tij është ushtruar në Gjykatën Komunale të VITISË me 28 prill 2010 brenda afatit 15-ditësh si të paraparë me Nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë LPK. *Së treti*, ankesa nuk është e palejueshme sipas Nenit 186, paragrafi 3 LPK. Ajo është ushtruar në emër të paditësit në procedurë të shkallës së parë i cili e ka të drejtën dhe interesin ligjor për ta paraqitur dhe nuk e ka refuzuar apo të ketë heq dorë nga ajo. Ankesa është e nënshkruar nga Avokati SHEMSEDIN PIRAJ, i autorizuar nga paditësi në bazë të autorizimit, të datës 15 tetor 2001 i cili është i përgjithshëm dhe brenda veprimeve të autorizuara përshinë saktësisht këtë mjet juridik- Neni 90, paragrafi 2, pika a) LPK. *Së katërti*, ankesa ka përmbajtje të detyrueshme siç kërkohet me Nenin 178, pikat a) – d) LPK dhe nuk është e paplotësuar sipas Nenit 179, paragrafi 1 LPK. Prandaj, nuk ka baza ligjore që e përjashtojnë lejueshmërinë e ankesës dhe/ose të kësaj procedure të shkallës së dytë sipas Neneve 176 – 205 LPK.

IV. Përmbledhje e procedurës së shkallës së parë

9. Me 17 tetor 2001 FARI FETAHU parashtroi një padi kundër MIRVETE SALIHI, të dy nga VITIA, të regjistruar me shenjën C.nr.118/2001 të Gjykatës Komunale të VITISË. Kërkesat ishin se paditësi ishte vëllai i ARIF FETAHUT i cili vdiq me 3 shtator 2000, ndërsa e paditura kishte marrëdhënie jashtëmartesore me te. Deri me 1997 të gjithë ata si dhe familjarët e tjerë jetonin në të njëjtën shtëpi dhe ekonomi familjare si një familje e rëndomtë në fshatin VËRBAN, Komuna e VITISË. Me mjetet e fituara nga kultivimi i tokës bujqësore – prona e tyre e përbashkët,

kursimet e depozituara në valutë të huaj nga babai i FARI FETAHU dhe ARIF FETAHUT i cili punonte me dekada jashtë vendit, si dhe nga fitimi i përbashkët të firmës tregtare "ARTA-COMMERCE", bazuar në një marrëveshje të përbashkët ata blenë prona, duke përfshirë këtu ngastrën kadastrale nr.147/4, sipas kopjes së planit nr.3/11, në vendin e quajtur "RASULA", me kulturë – arë e klasës së III-të, në sipërfaqe prej 0.20.00 ha, ZK DROBESH, të regjistruar në Fletë Posedimin me numër të ri në emër të ARIF FETAHUT. Megjithatë, pas vdekjes së tij, MIRVETE SALIHU-FETAHU mohoi kontributin e FARI FETAHUT për blerjen e kësaj prone. Padiësi kërkoi nga Gjykata që ta konfirmoj bashkëpronësinë mbi ngastrën kadastrale në pjesë të njëjta prej 1/2 për çdonjërin nga palët ndërgjyqës. Padia gjithashtu përmbante edhe thënie të ngjashme për dy banesa në cilat pjesë padia është vendosur përfundimisht dhe aktualisht nuk është e pakryer si objekt i kontestit.

10. Me 9 gusht 2002, e paditura MIRVETE SALIHU-FETAHU nënshkroi autorizimin Avokatit IDRIZ BAJRAMI nga GJILANI për ta përfaqësuar atë në këtë lëndë dhe për të ushtruar mjetet e nevojshme të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

11. Me 12 gusht 2002, Avokati IDRIZ BAJRAMI paraqiti përgjigje në padi në emër të paditurës MIRVETE SALIHU-FETAHU.

12. Pas inicimit të procedurës urgjente kontestimore me Aktvendimin mbi Trashëgimin T.nr.50/01 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 12 dhjetor 2001, të vërtetuar me vulën e Gjykatës mbi plotfuqishmërinë kur edhe hynë në fuqi ky vendim me 4 janar 2002, MIRVETE SALIHU-FETAHU, ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU, BUJARE FETAHU, ARTON FETAHU, HUMANE FETAHU dhe ARIF FETAHU ishin shpallur trashëgimtarë ligjor e të ndjerit ARIF FETAHU me nga 1/7 të pronës së tij – objekti i trashëgimisë (pika I e dispozitivit). MIRVETE SALIHU-FETAHU ishte emëruar si e besuar për trashëgiminë e ARTA FETAHUT, ADELINA FETAHUT, BUJARE FETAHUT, ARTON FETAHU, HUMANE FETAHU dhe ARIF FETAHU, të gjithë të mitur në atë kohë, derisa të arrijnë moshën madhore (pika II e dispozitivit). Me Aktvendimin mbi trashëgiminë T.nr.50/2001 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 7 gusht 2002, të vërtetuar me vulën e Gjykatës mbi plotfuqishmërinë kur edhe hynë në fuqi ky vendim me 7 gusht 2002, rregullimi i parë i trashëgimisë së të ndjerit ARIF FETAHU ishte plotësuar midis trashëgimtarëve ligjor të përmendur më lartë për pjesët e njëjta ideale nga 1/7 të ngastrës kadastrale nr.147/4, në vendin e quajtur "RASULA", ZK DROBESH, në sipërfaqe prej 0.20.00 ha, të regjistruar në Fletën Poseduese të lëshuar nga DGCP– VITI. Në lëndën C.nr.118/2001 të Gjykatës Komunale të VITISË, të dy aktet gjyqësore ishin marr si prova dokumentuese dhe deklaratat e dëshmitarëve DELI FETAHU dhe KADRI FETAHU janë dëgjuar në shqyrtimin kryesor të mbajtur me 24 dhjetor 2002 vetëm me pjesëmarrjen e FARI FETAHUT dhe MIRVETE SALIHU-FETAHUT.

13. Me Aktgjykimin C.nr.118/2001 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 24 dhjetor 2002, të konfirmuar pas ankesës me Aktgjykimin AC.nr.79/2003 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 6 qershor 2003, është vërtetuar prona e padiësit

FARI FETAHU prej 1/2 të pjesës ideale të ngastrës së kontestuar kadastrale nr.147/4, dhe e paditura MIRVETE SALIHU-FETAHU ishte obliguar që t'ia njoh këtë të drejtë dhe regjistrimin kadastral nga ana e DGCP- VITI. Me Aktvendimin Rev.nr.143/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 18 dhjetor 2003 revizioni i MIRVETE SALIHU-FETAHUT është aprovuar - Aktgjykimi AC.nr.79/2003 i Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 6 qershor 2003 dhe Aktgjykimi C.nr.118/2001 i Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 24 dhjetor 2002 ishin të anuluar në pjesën për ngastrën kadastrale nr.147/4 dhe lënda është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi vendimin e vet me gjetjen e shkeljeve të Nenit 201 të Ligjit mbi Procedurë Kontestimore ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" Nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90, 27/90, 35/91 dhe "Gazeta Zyrtare e RSJ" Nr.27/92, 31/93, 24/94 dhe 12/98) (LPK 1977) për shkak të mos-pjesëmarrjes në këtë rast të gjashtë fëmijëve të të ndjerit ARIF FETAHU në çështjen e bashkuar me bashkëshorten e tij MIRVETE SALIHU-FETAHU, të gjithë si trashëgimtarë ligjor me të drejtë në trashëgiminë e tij në pjesë ideale prej 1/7.

14. Në rigjykimin e parë, lënda është regjistruar me shenjë C.nr.16/2004 të Gjykatës Komunale të VITISË. Me 6 maj 2005 padia i është kthyer paditësit për korrigjim deri me 21 qershor 2005 në pajtim me Aktvendimin Rev.nr.143/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 18 dhjetor 2003. Brenda afatit, me 20 qershor 2005, në emër të paditësit FARI FETAHU, përfaqësuesi i tij i autorizuar Avokati SHEMSEDIN PIRAJ ushtroi një parashtrësë për plotësimin, korrigjimin dhe precizimin e padisë ashtu që ajo duhet të konsiderohet si e ushtruar kundër MIRVETE SALIHU-FETAHU, ADELINA FETAHU, ARTA FETAHU, BUJARE FETAHU, ARTON FETAHU, HUMANE FETAHU dhe ARIF FETAHU, të gjithë si të paditur në cilësinë e tyre të bashkë-trashëguesve të të ndjerit ARIF FETAHU sipas Aktvendimit mbi Trashëgiminë T.nr.50/01 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 12 dhjetor 2001. Pavarësisht nga ky plotësim i padisë, me 21 qershor 2005 është mbajtur shqyrtimi kryesor vetëm me pjesëmarrjen e palëve të para ndërgjyqëse- FARI FETAHU si paditës dhe MIRVETE SALIHU-FETAHU si e paditur, pa i ftuar për seancë gjyqësore, pa prezencën dhe/ose pjesëmarrjen e të paditurve të themeluar rishtas- ADELINA FETAHU, ARTA FETAHU, BUJARE FETAHU, ARTON FETAHU, HUMANE FETAHU dhe/ose ARIF FETAHU. Në të njëjtën seancë dëshmitari ENVER REXHEPI dha deklaratën e tij duke thënë se me 1995 ai e shiti ngastrën e kontestuar ARIF FETAHUT, i cili e bleu atë për vete dhe se ai personalisht e pagoi çmimin e akorduar prej 5 000 DM. Shqyrtimi kryesor i lëndës C.nr.16/2004 i Gjykatës Komunale të VITISË vazhdoi me 8 gusht 2005, në të cilën seancë MIRVETE SALIHU-FETAHU morri pjesë vetë dhe si përfaqësuese e të gjithë fëmijëve e të të ndjerit ARIF FETAHU.

15. Rigjykimi i parë në këtë lëndë ishte përfunduar me Aktgjykimin C.nr.16/2004 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 8 gusht 2004, për refuzimin e padisë së FARI FETAHUT për vërtetimin e pjesës ideale të tij prej 1/2 të ngastrës kadastrale nr.147/4. Pastaj i ankimuar, ky Aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin AC.nr.300/05 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 24 mars 2006. Revizioni i

ushtruar nga FARI FETAHU është aprovuar me Aktvendimin Rev.nr.159/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 20 maj 2008 - Aktgjykimi AC.nr.300/2005 i Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, i datës 24 mars 2006 dhe Aktgjykimi C.nr.16/04 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 8 gusht 2005 ishin prish dhe lëndë i është kthyer Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Gjykata Supreme e Kosovës gjeti shkelje thelbësore të Nenit 354, paragrafi 1, pika 11 LPK 1977, për shkak të përfaqësimit të paligjshëm të paditurve ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU dhe BUJARE FETAHU. Do me thënë, është marrë parasysh se kujdestaria e MIRVETE SALIHU-FETAHU për të gjithë të miturit e themeluar sipas Vendimit Nr. 79-1/2001, Vendimit Nr. 79-2/2001 dhe Vendimit Nr. 79-3/2001, të gjitha të lëshuara me 27 korrik 2001 nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale (QPS) - VITI ishte ndërprerë me Vendimin Nr. 1038-1/04, të datës 6 shtator 2004, Vendimin Nr. 1038-2/04, të datës 6 shtator 2004, dhe Vendimi i datës 17 mars 2006 nga Drejtori i QPS – VITI dhe si kujdestar i tyre i ri është caktuar FATIME FETAHU nga VITIA bazuar ne Nenin 22, Nenin 210 dhe nenin 237 të Ligjit mbi Martesat dhe Marrëdhënie Familjare (LMMF) (“Gazeta Zyrtare e KSAK Nr.10/1984). Si pasojë, MIRVETE SALIHU-FETAHU nuk ka mundur të veproj si përfaqësuese ligjore e këtyre të paditurve dhe nuk ka mundur të japë autorizimin në emër të tyre cilit do përfaqësues të autorizuar. Gjithashtu është theksuar se ARTA FETAHU, e lindur me 1 prill 1988 dhe ADELINA FETAHU, e lindur me 30 qershor 1990, arritën mpihen madhore gjatë procedurës gjyqësore. Gjykata e shkallës së parë ishte e obliguar nga Gjykata Supreme e Kosovës t’i eliminoj në rigjykim të gjitha këto mangësi.

16. Pas ridërgimit, kjo lëndë është regjistruar me shenjën C.nr.205/08 të Gjykatës Komunale të VITISË. Me 30 dhjetor 2008 një autorizim është prezantuar në shkresat e lëndës të lëshuar nga Byroja e Qarkut për Ndihmë Juridike – GJILAN me 24 dhjetor 2008 në emër të Avokatit VISAR MUSA nga VITIA për ta përfaqësuar shfrytëzuesen e ndihmës ligjore MIRVETE SALIHUN në lëndën për konfirmimin e pronësisë *lidhur me Revizionin Rev.nr.156/06*. Me 31 dhjetor 2008 një kundërpadi e nënshkruar nga Avokati VISA MUSA është dorëzuar në emër të “*MIRVETE FETAHU dhe të tjerë*” kundër FARI FETAHUT, megjithatë pa elemente të detyrueshme që përfshin një deklaratë të saktë e të duhur. Në këtë rigjykim të dytë shqyrtimi kryesor u mbajt me 9 janar 2009 gjatë së cilës Avokati VISAR MUSA veproi si përfaqësues i MIRVETE SALIHU-FETAHU, ARTON FETAHU, HUMANE FETAHU dhe ARIF FETAHU, ARTA FETAHU dhe ADELINA FETAHU prezantuan personalisht, ndërsa për BUJARE FETAHU prezantoi MITAT MISINI nga QPS–VITI. Me Aktgjykimin të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 9 janar 2009 padia është refuzuar (pika I e dispozitivit), ndërsa kundërpadia e kualifikuar për lirim e ngastrës së kontestuar kadastrale nr.147/4 është aprovuar (pika II e dispozitivit). Me Aktvendimin AC.nr.76/09 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 28 shtator 2009 sipas Nenit 195, pika c) LPK ankesa e FARI FETAHUT aprovohet – Aktgjykimi C.nr.265/2008 i Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 9 janar 2009 anulohet dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pikat k) dhe n)

LPK. Së pari, në Aktgjykim FARI FETAHU është cilësuar si paditës- kundër i paditur, MIRVETE SALIHU-FETAHU, ARTON FETAHU, HUMANE FETAHU dhe ARIF FETAHU si të paditurit -- kundër-paditësit, ndonëse kundërpadia e 31 dhjetor 2008 është nënshkruar nga Avokati VISAR MUSA vetëm për MIRVETE SALIHU -FETAHUN, me një përmbajtje të pakuptueshme dhe jo të plotë e cila më pas nuk është korrigjuar apo plotësuar sipas Nenit 102, paragrafi 1 LPK. Së dyti, Gjykata e Qarkut e GJILANIT theksoi se në C.nr.265/08 të Gjykatës Komonale të VITISË e mitura BUJARE FETAHU ishte përfaqësuar përmes MITAT MISINIT nga QPS – VITI, pa vendim për emërimin e tij si kujdestar për këtë procedurë që duhej të ishte vendosur në shkresat e lëndës në kundërshtim me Nenin 76 LPK. Së fundi, Gjykata e Qarkut e GJILANIT dha udhëzime për udhëheqjen e procedurës së rigjyimit.

17. Pas ridërgimit, lënda është regjistruar me shenjën C.nr.359/2009 të Gjykatës Komonale të VITISË. Me 20 janar 2010 një letër i është dërguar QPS– VITI nga ana e Gjyqtarit të lëndës për emërimin e përfaqësuesit të miturës- të paditurës BUJARE FETAHU nga Organi i Kujdestarisë për këtë procedurë meqenëse kujdestarja i saj FATIME FETAHU është bashkëshortja e FARI FETAHUT ajo nuk mund ta përfaqësoj atë për shkak të këtij konfliktit të interesit. Nuk është pranuar ndonjë përgjigje zyrtare nga QPS–VITI/VITINA derisa lënda C.nr.359/2009 e Gjykatës Komonale të VITISË kishte përfunduar. Seancat gjyqësore të 22 shkurtit 2010, 26 marsit 2010 dhe 6 prillit 2010, bazuar në procesverbalet të tyre, ishin të udhëhequr me prezencë të FARI FETAHU si një paditës- kundër-i paditur dhe të përfaqësuesit të tij të autorizuar Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ, MIRVETE SALIHU-FETAHU si një e paditur- kundërpaditëse dhe gjithashtu “përfaqësuesi ligjor i të paditurve-kundërpaditësve” HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU, dhe ARIF FETAHU, të gjithë të përfaqësuar nga Avokati VISAR MUSA, ADELINA FETAHU dhe ARTA FETAHU, të dyja si të paditurat, dhe MITAT MISINI nga QPS – VITI “si një përfaqësues i të paditurës BUJARE FETAHU”. Seancat e 22 shkurti 2010 dhe 26 marsi 2010 ishin shtyrë pas kërkesës së palëve me qëllim të arritjes së marrëveshjes. Seanca e 6 prillit 2010 ishte mbajtur si seancë për shqyrtim kryesor- gjatë së cilës janë paraqitur deklaratat nga ana e paditësit- kundër të paditurit FARI FETAHUT, Avokatit VISAR MUSA si përfaqësues i MIRVETE SALIHU-FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU, ARIF FETAHU si të paditur- kundërpaditës, ADELINA FETAHU dhe ARTA FETAHU si të paditura, sikurse edhe MITAT MISINI nga QPS–VITI si përfaqësues i të paditurës BUJARE FETAHU, dhe bazuar në propozimet e tyre si prova dokumentuese janë lexuar deklaratat e DELI FETAHU dhe KADRI FETAHI në procesverbalet e 24 dhjetorit 2002 dhe deklarata e ENVER REXHEPI në procesverbalin e 21 qershori 2005 si dhe Aktvendimi mbi Trashëgimi T.nr.50/01 i Gjykatës Komonale të VITISË, të datës 7 gusht 2002. Seanca kryesore e 6 prilli 2010 ishte kryer me fjalët përfundimtare të pjesëmarrësve të sipërpërmendur.

18. Me Aktgjykimin C.nr.359/2009 të Gjykatës Komonale të VITISË, të datës 6 prill 2010, padia e paditësit FARI FETAHU kundër të paditurve MIRVETE SALIHU-FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU, ARIF FETAHU, ARTA

FETAHU, ADELINA FETAHU dhe BUJARE FETAHU për vërtetimin e pronësisë në pjesë ideale prej 1/2 të ngastrës kadastrale nr.147/4 ishte refuzuar. Arsyetimi është bazuar mbi Aktvendimin T.nr.50/2001 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 7 gusht 2002 sipas të cilit të paditurit ishin përcaktuar si bashkë-pronarë bazuar në trashëgiminë e të ndjerit ARIF FETAHU, sikurse edhe bazuar në deklaratën e ENVER REXHEPI dhënë me 21 qershor 2005 se me 1995 ai e shiti ngastrën ARIF FETAHUT, i cili vet e pagoi çmimin e plotë. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë supozoj se ai si paditës nuk ka marrë pjesë në këtë transaksion ligjor dhe nuk kontribuoi në blerjen e kësaj paluajtshmërie, ai nuk fitoi ndonjë pjesë ideale në këtë pronësi.

V. Ekzaminimi ankimor sipas Nenit 194 LPK

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore - Neni 182 LPK

19. Arsyeya e pare për ekzaminimin e Aktgjykimit C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 20 prill 2010 është bërë sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK për *Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore* sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK lidhur me *zotësinë procedurale dhe/ose përfaqësimi* i palëve ndërgjyqëse brenda kufijve të treguara në ankesë, sikurse edhe brenda njërës lëndë për të cilën kujdeset sipas *detyrës zyrtare* në ekzaminim ankimor sipas Nenit 194 LPK.

20. Siç është përcaktuar në Aktvendimin Rev.nr.145/03 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 6 qershor 2003, të gjithë bashkë- trashëgimtarë e të ndjerit ARIF FETAHU mbi të cilët është transferuar ngastra e kontestuar kadastrale nr.147/4 sipas trashëgimisë paraqesin një bashkësi ligjore të rëndomtë e të pandarë. Për shkak të natyrës së kësaj marrëdhënie ligjore, kontesti për bashkë-pronësi të pretenduar të FARI FETAHU në ngastrën kadastrale nr.147/4 në pjesë ideale prej 1/2 mund të zgjidhet vetëm në të njëjtën mënyrë për sa i përket të gjithë bashkë-trashëgimtarëve të të ndjerit ARIF FETAHU *në çështjen e bashkuar* në të cilën të gjithë janë të konsideruar si një palë e veçantë sipas nenit 201 LPK i 1977 (tani Neni 269, paragrafi 1 LPK). Prandaj, parregullsitë më poshtë për sa i përket caktimin e ndonjë nga këta ndërgjyqës në lëndë dëmtojnë zotësinë e tyre procedurale të një pale të veçantë. *Së pari*, në rigjykim, pas Aktvendimit Rev.nr.145/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 6 qershor 2003, përmes parashtresës së datës 20 qershor 2005 (pa vulë pranimi nga Gjykata për atë datë) Avokati SHEMSEDIN PIRAJ, në emër të paditësit FARI FETAHU kërkoi ndryshimin, korrigjimin dhe precizimin e padisë dhe kështu ajo është konsideruar si e ushtruar kundër të gjithë bashkë- trashëgimtarëve e të ndjerit ARIF FETAHU të shpallur sipas Aktvendimeve mbi Trashëgiminë T.nr.50/2001 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 12 dhjetor 2001 dhe 7 gusht 2002. Megjithatë, parashtresa nuk pati të gjitha elementet e detyrueshme, posaqërisht ato lidhur me veçimin e të paditurve të mitur ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU, BUJARE FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU – datat e lindjes së tyre si të nevojshme për të caktuar zotësinë e tyre procedurale dhe ligjin e aplikueshëm përkatës për pjesëmarrjen e tyre në këtë procedurë (Neni 186,

paragrafi 1 lidhur me Nenin 106, paragrafi 2, fjalja e parë LPK 1977), sikurse edhe të përfaqësuesit ligjor për ata që nuk e kanë zotësinë procedurale (Neni 186, paragrafi 1 lidhur me Nenin 106, paragrafi 2, fjalja e dytë LPK 1977). Asnjëra nga këto mangësitë e padisë nuk janë korigjuar më pas, e as që është azhurnuar përmbajtja e saj pasi që ADELINA FETAHU dhe ARTA FETAHU, të shënuara aty si të paditurat e mitur, e kanë arritur moshën madhore me 1 prill 2006 dhe respektivisht me 30 qershor 2008. Kështu, rigjykimi në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË që ishte udhëhequr përmes legjitimitetit procedural pasiv të të paditurve nuk ka qenë e identifikuar sipas rregullit me këtë padi apo sipas *detyrës zyrtare* bazuar në Nenin 76 LPK për sa i përket *zotësisë procedurale* sipas Nenit 74 LPK të këtyre ndërgjyqësve ose të *përfaqësuesve të tyre ligjor* sipas Nenit 75 LPK. *Së dyti*, fillimisht padia ishte ushtruar me 17 tetor 2001 kundër MIRVETE SALIHU-FETAHU, dhe më vonë ishte zgjeruar përmes parashtresës nga Avokati SHEMSEDIN PIRAJ, me 20 qershor 2005 për të përfshirë në atë si të *padituritë shtesë* ARTA FETAHUN, ADELINA FETAHUN, BUJARE FETAHUN, HUMANE FETAHUN, ARTON FETAHUN dhe ARIF FETAHUN. Megjithatë, *pëlqimi* saktësisht i tyre paraparë me Nenin 196, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, pika a) LPK 1977 (tani Neni 264, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, pika a) LPK) nuk ka qenë i theksuar në asnjë moment dhe në asnjë formë gjatë procedurës. Pra, rigjykimi në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË ishte udhëhequr edhe pse ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU, BUJARE FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU nuk e kanë dhënë pëlqimin e tyre të obligueshëm dhe nuk kanë pas sipas rregullit statusin e paraparë me Nenin 196, paragrafi 3 LPK 1977 (tani Neni 264, paragrafi 3 LPK) si të paditur plotësues. Prandaj, kjo çështje e bashkuar e të gjithë bashkë-trashëgimtarëve të të ndjerit ARIF FETAHU sipas Nenit 201 LPK 1977 (tani Neni 269 LPK) nuk është krijuar me rregull si bazë për *zotësinë e tyre specifike procedurale si palës e veçuar* siç parashihet me këto dispozita. *Së treti*, ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU, BUJARE FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU nuk janë pajtuar të bëhen të paditur plotësues dhe kështu nuk kanë pranuar të statusin e lëndës në atë moment përkatës siç edhe parashihet me Nenin 196, paragrafi 1 LPK 1977 (tani Neni 264, paragrafi 1 LPK). Pra ata nuk ishin të obliguar nga ndonjë veprim procedural të ndërmarrë në lëndë para këtij momenti sipas Nenit 196, paragrafi 3 LCP 1977 (tani Neni 264, paragrafi 3 LPK). Për sa i përket atyre mëpasshme, ato janë udhëhequr pa *Lis Pendens* të themeluar rregullisht për këta të paditur plotësues në pajtim me Nenin 194, paragrafët 1 ose 2 LPK 1977 (tani Neni 261, paragrafët 1 ose 2 LPK) përmes dorëzimit fillestar dhe të mëpasshëm të padisë çdonjërës prej palëve për të dhënë përgjigje. Dorëzimi i saj te i padituri plotësues MIRVETE SALIHU-FETAHU nuk ka mundur të prodhoj efekt ligjor bashkë-trashëgimtarëve të tjerë të të ndjerit ARIF FETAHU bazuar në supozimin e Nenit 201, paragrafi 1 LPK 1977 (tani Neni 269, paragrafi 1 LPK) me që nuk është i aplikueshëm për veprimet procedurale të Gjykatës, duke përfshirë edhe ato të parapara me Nenin 284, paragrafi 1 LPK 1977 (tani Neni 394 LPK). Pa ekzistimin e *Lis Pendens* sipas Nenit 194, paragrafët 1 ose 2 LPK 1977 (tani Neni 261,

paragrafët 1 ose 2 LPK) marrëdhëniet procedurale nuk ishin të themeluara sipas rregullit me këta trashëgimtarë ligjor të të ndjerit ARIF FETAHU dhe *ata nuk kishin të drejtë të veprojnë si palë në procedurë*. Për këtë shkak pjesëmarrja e tyre në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË në këtë zotësi duhet të cilësohet si shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në *pjesën e parë të Nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK*.

21. Rigjykimi në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË ishte mbajtur me pjesëmarrjen e Avokatit VISAR MUSA si përfaqësues i MIRVETE SALIHU-FETAHU, sikurse edhe të fëmijëve të saj të mitur HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU. Megjithatë, *ai nuk pati autorizim të rregullt për përfaqësim të tillë në këtë procedurë*. Me 31 dhjetor 2008 Avokati VISAR MUSA prezantoi një parashtrësë të autorizimit të tij për ta bashkëngjitur shkresave të lëndës, lëshuar me 24 dhjetor 2008 nga SADULLA SALIHU – Zyrtar Ligjor i Byrosë së Qarkut për Ndihma Juridike – GJILAN për ta përfaqësuar MIRVETE SALIHU nga VITIA me numër të letërnjoftimit të UNMIK-ut nr.1013219539, si ndihmë juridike për shfrytëzuesin që është regjistruar në Byronë e Qarkut (BQNJ) si DBLA-05, C.320/08-05 në lëndën për vërtetimin e së drejtës së pronësisë lidhur me Revizionin Rev.156/2006. Vlefshmëria i autorizimit ishte veçanërisht e përkufizuar në përfundimin e procedurës së sipërpërmendur dhe përdorimi i tij për ndonjë qëllim tjetër ishte veçanërisht i ndaluar. Dokumenti ishte i nënshkruar personalisht nga MIRVETE SALIHU, vetëm për vete dhe *anasjelltas* dhe jo për fëmijët e saj HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU emrat e të cilëve nuk u shënuan fare. Deri në përfundim të rigjykimit në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË, ky dokument nuk u ndryshua e as zëvendësuar me ndonjë tjetër. Bazuar në këtë dokument, Avokati VISAR MUSA nuk ishte i titulluar të veproj si përfaqësues i MIRVETE SALIHU -FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË. *Së pari*, sistemi i ndihmës juridike i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/36 synon në përmirësimin e qasjes në drejtësi të personave të kualifikuar, financiarisht të përshtatshëm sipas kriterit të tij, *ndër të tjera* duke siguruar *përfaqësimin e tyre para Gjykatave*. - Neni 2, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika (b). Prandaj, çdo Byro e Qarkut për Ndihma Juridike sipas Nenit 6, paragrafi 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 është e autorizuar: 1) të përcaktoj nëse kërkuesi i ndihmës juridike është përfitues i kualifikuar i ndihmës së tillë, financiarisht i përshtatshëm për ndihmë juridike primare dhe sekondare - Neni 6, paragrafi 2, pikat (b) dhe (c); 2) të përcaktoj nëse ndihma e kërkuar është brenda fushës së shërbimeve të ndihmës juridike - Neni 6, paragrafi 2, pika (d); 3) të vendos mbi kërkesat për ndihmë juridike - Neni 6, paragrafi 2, pika (e); dhe 4) të siguroj ofrimin e ndihmës juridike në përputhje me vendimin duke e drejtuar kërkuesin tek ofruesi i duhur - Neni 6, paragrafi 2, pika (g). Në këtë lëndë konkrete akti i Byrosë së Qarkut për Ndihma Juridike – GJILAN, të datës 24 dhjetor 2008 paraqet *një vendim për aplikimin e ndihmës juridike për MIRVETE FETAHU-SALIHU të regjistruar në BQNJ si DBLA-05, C no.320/2008 sipas nenit 13.10, pikat (a) – (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 duke përfshirë përcaktimin se ajo është një person i*

përshtatshëm sipas Nenit 10, e cila është financiarisht e pranueshme si pranues i ndihmës juridike sipas Nenit 11 dhe ndihma e kërkuar është brenda fushës së shërbimeve juridike të mundshme sipas Nenit 9. Megjithatë, kjo e drejtë është marrë në mënyrë të paligjshme meqenëse në kundërshtim me Nenin 13.10, pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 *ndihma juridike e dhënë tejkalon kufijtë e shërbimeve të autorizuar*. Në procedurat që kanë të bëjnë me pronë ndihma primare dhe sekondare ligjore janë të kufizuara në mënyrë të njëjtë sipas Nenit 9, paragrafi 1, pika (c) dhe paragrafi 2, pika (c) Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36, përkatësisht, në *përfaqësimin ligjor të paditësve dhe të paditurve lidhur me pronësinë, posedim ose okupim të vendbanimit apo banesë së tyre kryesore*. Në këtë rast konkret ky kriter nuk është përmbushur – objekti i rigjykimit në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komonale të VITISË është bashkë-pronësia e *tokës bujqësore* (ngastra kadastrale nr.147/4 me kulturë – e klasës së III-të, e cila është jashtë fushës së trajtimit të *ndihmës juridike primare dhe sekondare* në lëndët civile që kanë të bëjnë me çështjet pronësore, të *përkufizuar në mënyrë të domosdoshme* me Nenin 9, paragrafi 1, pika (c) dhe paragrafi 2, pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 *vetëm për pronat e banueshme*. Nihma juridike nuk mund të konsiderohet si e ofruar jashtë fushës së ndihmës juridike primare dhe sekondare të përcaktuar me Nenin 9, paragrafi 3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 – *së pari* kjo kompetencë i takon ekskluzivisht Komisionit për Ndhimë Juridike sipas Nenit 4.1 dhe jo BQNJ sipas Nenit Section 6.1, dhe *së dyti* kjo ndihma e jashtëzakonshme juridike mund të jepet vetëm në partneritet me OJQ-të, me programe studentore, ose në partneritet me klinikat e ndihmës juridike sipas Nenit 8.2, pikat (c) – (e) dhe *anasjelltas* jo nga anëtarët e listës së shërbimit nëpër qarqe sipas Nenit 8.2, pika (a). Për atë, vendimi i BQNJ GJILAN, të datës 24 dhjetor 2008 për të dhënë ndihmën juridike MIRVETE SALIHU -FETAHU përmes përfaqësimit në padinë lidhur me bashkë-pronësinë të *pronës jo-banuese tejkalon kompetencat e saj* të kufizuar sipas Nenit 13, paragrafi 10, pika c) të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 për ofrimin e shërbimeve të mundshme brenda fushës së ndihmës juridike primare dhe sekondare sipas Nenit 9, paragrafët 1 dhe 2. Prandaj, ky vendim sipas kërkesës së MIRVETE SALIHU-FETAHU, të datës 24 dhjetor 2008 në pjesën e saj për *vërtetimin e së drejtës së ndihmës ligjore* lëshuar nga një organ jokompetent publik është *absolutisht i paligjshëm* sipas Nenit 92, pika (b) të Ligjit Nr. 02/L-28 mbi Procedurë Administrative (LPA). Bazuar në te, ai është *absolutisht i paligjshëm* sipas Nenit 93, paragrafi 5 LPA, është pjesë shtesë e të njëjtit vendim për *ofrimin e kësaj ndihme juridike* duke e drejtuar kërkesën MIRVETE SALIHU-FETAHU te ofruesi i duhur, sipas Nenit 6, paragrafi 2, pika (g), nën-pika (i) të Rregullores së UNMIK-it Nr. 2006/36 – te Avokati VISAR MUSA i emëruar nga Lista e shërbimit nëpër qarqe si përfaqësues i saj. Prandaj, vendimi i BQNJ- GJILAN, të datës 24 dhjetor 2008 duke e qenë se është marr për ofrimin e *ndihmës juridike jashtë fushës së ndihmës juridike primare dhe sekondare* të përkufizuar me Nenin 9, paragrafi 1, pika (c) dhe paragrafi 2, pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 pa kompetenca për zgjerimin e kësaj fushe të veprimit, të ruajtur, sipas Nenit 9.3, vetëm për Komisionin për Ndhimë Juridike sipas nenit 4.1, është absolutisht i paligjshëm sipas nenit 92, pika (b) LPA, nuk ka prodhuar pasoja ligjore – Neni 93, paragrafi 1 LPA dhe duhet të injorohet nga

ana e Gjykatës- Neni 93, paragrafi 2 LPA. Pra, emërimi i Avokatit VISAR MUSA si përfaqësues për kërkuesen e ndihmës juridike MIRVETE SALIHU-FETAHU nuk është *emërim nga një autoritet kompetent shtetëror, të marr në pajtim me ligjin, e të kërkuar sipas Nenit 75, paragrafi 2 LPK*. Si pasojë, pjesëmarrja e këtij Avokati në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË si përfaqësues kësaj pale pa një autorizim të tillë të rregullt paraqet shkelje thelbësore procedurale në *pjesën e katërtë të Nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK*. Së dyti, pavarësisht nga kjo paligjshmëri absolute, vendimi i përmendur i BQNJ – GJILAN, të datës 24 dhjetor 2008 nuk mund ta ligjëroj Avokatin VISAR MUSA si një përfaqësues në këtë lëndë. Me që autorizimi i tij është dhënë veçanërisht **vetëm për Revizionin Rev.nr.156/06**, fusha e tij e veprimit është e përkufizuar për këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik dhe për *argumentum ad contrario* dhe të gjitha procedurat tjera janë jashtë kufijve të tij. Bazuar në këtë autorizim për Rev.nr.156/06 të Gjykatës Supreme të Kosovës, Avokati VISAR MUSA nuk mund të veproj si përfaqësues në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË. Për rigjykim të kësaj lënde të shkallës së parë ai nuk ka pasur emërim, siç kërkohet me Nenin 75, paragrafi 2 LPK, nga ndonjë institucion për ndihmë juridike nga ato të shënuara në Nenin 2, pika (i) të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2006/36. Pa qenë i autorizuar me përfaqësim të ofruesit të ndihmës juridike sipas Nenit 6, paragrafi 2, pika (g), nën-pika (i) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË, Avokati VISAR MUSA në këtë rast nuk mund të udhëheq asnjërin nga veprimet e numëruara në Nenin 77, paragrafi 1 LPK. Pra, pjesëmarrja e tij si përfaqësues i MIRVETE SALIHU-FETAHU pa emërimin e nevojshëm për marrjen e kësaj zotësie ligjore në këtë lëndë të shkallës së parë paraqet shkelje pasuese procedurale sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK. Së treti, nuk ka ndonjë akt në shkresat e lëndës për përfaqësimin e HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe/ose ARIF FETAHU nga Avokati VISAR MUSA. Emrat e tyre nuk përmenden në asnjë kontekst në vendimin e BQNJ – GJILAN, të datës 24 dhjetor 2008. Kjo e fundit është nënshkruar vetëm nga MIRVETE SALIHU-FETAHU *për vete dhe jo për fëmijët e saj*. Me që Avokati VISAR MUSA kurrë nuk është amëruar për përfaqësues të tyre përmes një akti nga autoriteti kompetent shtetëror sipas Nenit 75, paragrafi 2 LPK dhe kurrë nuk është autorizuar nga MIRVETE SALIHU-FETAHU si nëna e tyre, sipas Nenit 89 lidhur me Nenin 77, paragrafi 1 LPK, të gjitha veprimet e tij të marra në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË në emër të HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU janë të paautorizuara. Të marra nga Avokati VISAR MUSA pa status të fituar sipas rregullit të përfaqësuesit të këtyre ndërgjyqësve të mitur, veprimet e tij të ndërmarra në këtë lëndë në emër të tyre janë të paligjshme, jo- të detyruese për ata dhe pa efekt ligjor në procedurë. Këto parregullsi në përfaqësimin e HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU nga ana e Avokatit VISAR MUSA pa ndonjë autorizim për të vepruar në këtë lëndë për këto palë është gjithashtu shkelje procedurale brenda Nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK.

22. Përfaqësimi i BUJARE FETAHU në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË ishte gjithashtu me gabime thelbësore procedurale. Ajo ka lindur me 1 prill 1993 siç është verifikuar zyrtarisht me Vendimin Nr. 1038-2/04 të Drejtorit të QPS-

VITI, të datës 6 shtator 2004, ajo ishte e mitur gjatë procedurës gjyqësore – që nga inicimi i saj me Aktvendimin AC.nr.76/09 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 28 shtator 2009 për kthimin e lëndës në Gjykatën e shkallës së parë në rigjykim e deri në përfundimin e saj me Aktgjykimin C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 6 prill 2010. Si një e mitur e cila nuk ka realizuar zotësinë e plotë për të vepruar vetë, sipas Nenit 74, paragrafi 1 LPK, BUJARE FETAHU e kishte zotësinë procedurale për të vepruar *vetëm brenda kufijve të pranuar të zotësisë së saj për të vepruar* sipas Nenit 74, paragrafi 3 LPK. Për *argumentum ad contrario*, ajo nuk pati zotësi procedurale për të vepruar jashtë kufijve të njëjtë dhe është dashur të përfaqësohet nga përfaqësues ligjor, sipas Nenit 75, paragrafi 1 LPK. Kjo është hipotezë. Rasti i gjykuar sipas lëndës C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË – e drejta e bashkë-pronësisë së pronës së paluajtshme e trashëguar nga BUJARE FETAHU me trashëgimtarë tjerë ligjor të të ndjerit ARIF FETAHU – *nuk ishte brenda kufijve të zotësisë së saj për të vepruar* siç pranohet me Nenin 136 dhe 217 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës (Ligji Nr. 2004/32) (“Gazeta Zyrtare e IPV të Kosovës” Nr. 4/2006) për transaksione ligjore, marrëdhëniet e punës, posedim dhe rregullimin e të ardhurave personale dhe të pronës së fituar me punën e saj. Kështu, në lëndën e shkallës së parë BUJARE FETAHU nuk ka mundur të ketë zotësinë e pjesshme procedurale, sipas Nenit 74, paragrafi 3 LPK të pranuar vetëm brenda këtyre kufijve dhe jo jashtë fushës së veprimit të tyre. Pra, statusi i saj në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË ishte *e një ndërgjyqësi të mitur pa zotësi procedurale*, i cili nuk ka mundur të veproj personalisht dhe është dashtë të përfaqësohet për të gjitha veprimet gjatë procedurës nga një përfaqësues ligjor, sipas Nenit 75, paragrafi 1 LPK. Ky kriter nuk është përmbushur. *Së pari*, pas vdekjes së ARIF FETAHU me 3 tetor 2002, me Vendimin e QPS – VITI nr.79-3/2001, të datës 27 korrik 2001 dhe Aktvendimin mbi Trashëgimin T.nr.50/01 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 12 dhjetor 2002 (pika II e dispozitivit) MIRVETE SALIHU–FETAHU ishte caktuar kujdestare e të miturës BUJARE FETAHU, derisa ajo u bë e moshës së rritur. Me Vendimin Nr.1038-2/04 të QPS- VITI, të datës 6 shtator 2004, bazuar në Nenin 22 të Ligjit mbi Martesat dhe Marrëdhënie Familjare (LMMF) (“Gazeta Zyrtare e KSAK” No.10/1984) kjo kujdestari u ndërpre që nga data 6 shtator 2004 dhe për kujdestar të ri të BUJARE FETAHU si një fëmijë pa kujdes prindëror, u caktua grua e axhës së saj FATIME FETAHU, e lindur me 22 shkurt 1960, me vendbanim në VITI. Me që *shkalla e autorizimit të saj ishte e përgjithshme*, në fushën e veprimit të saj ky përfaqësim ligjor i BUJARE FETAHU nga kujdestari i saj FATIME FETAHU ishte gjithashtu i përfshirë, duke u bazuar në Nenin 225, paragrafi 1 LMMF. Ky autorizim ishte i ligjshëm për *të gjitha veprimet e të drejtës materiale* për këtë të mitur me përjashtim të atyre nën Nenin 253, paragrafët 1 dhe 2 LMMF dhe për të gjitha veprimet procedurale në përjashtim të ankesave të parashikuara me Nenin 254 LPK. Megjithatë, ushtrimi i këtij përfaqësimi në procedurë civile ishte *përkufizuar* me kriteret për aprovimin e Organit të Kujdestarisë në hipotezën e Nenit 255, pika 4 LMMF, dhe *e përjashtuar* në hipotezat e konfliktit të interesit sipas Nenit 268 LMMF kur duhet të caktohet një kujdestar i posaçëm. Ky status i kujdestarit të

FATIME FETAHU i krijuar mbi bazat e LMMF pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Familje të Kosovës (Ligji Nr. 2004/32) (LF) ("Gazeta Zyrtare e IPV të Kosovës Nr. 4/2006) i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2006/7 me 16 shkurt 2006, nga kjo datë dhe tutje, ishte rregulluar me këtë Ligj të ri sipas parimit kalimtar të Nenit të tij 353, dhe përparësia e tij si ligj i aplikueshëm sipas Nenit 1.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 mbi LMMF si ligj i aplikueshëm sipas Nenit 1.1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24. Në veçanti, pas 16 shkurt 2006 FATIME FETAHU mbeti kujdestare e BUJARE FETAHU me besim sipas Nenit 243 LFK duke përfshirë *përfaqësim ligjor* të paraparë me Nenin 246, paragrafi 1 LFK të këtij fëmiju të mitur pa kujdes prindëror (Neni 216, paragrafi 1 LFK). Sa kohë që FATIME FETAHU nuk mund ta përfaqësoj BUJARE FETAHUN në padinë- objekt i lëndës C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË, ndërmjet FARI FETAHUT- bashkëshorti i kësaj kujdestareje dhe ndërmjet kësaj të miture e cila është nën kujdestari lidhur me ndalimin sipas Nenit 247, paragrafi 4 LFK, ky i fundit nuk e ndërpreu kujdestarinë (Neni 221 LFK), e as nuk çoj kah shkarkimi ose lirimi i kujdestarit (Neni 259 dhe respektivisht Neni 260 LFK). Për më tepër, ky përfaqësim ligjor sipas Nenit 246, paragrafi 1 LFK mbeti i pakufizuar me që nuk është i zëvendësuar me caktimin e paraparë me Nenin 75, paragrafi 2 LPK e një përfaqësues ligjor tjetër për këtë palë të mitur, që është marr me ndonjë alternativ ligjërish të paramenduar. Megjithëse, FATIME FETAHU nuk ishte ftuar për asnjë nga seancat gjyqësore në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË (Neni 107 LPK), ajo nuk morri pjesë në ato (Neni 428 - 431 LPK) dhe nuk ndërmori asnjë nga veprimet në procedurë gjyqësore (Neni 77, paragrafi 1 LPK). Për atë, *e mitura BUJARE FETAHU nuk ishte përfaqësuar në këtë lëndë nga ana e kujdestares së saj*, sipas Nenit 210, paragrafi 1 LMMF (Neni 236, paragrafi 1 LFK) *si përfaqësues ligjor me autorizim të përgjithshëm* sipas Nenit 225, paragrafi 1 LMMF (Neni 246, paragrafi 1 LFK). *Së dyti*, për shkak të ndalimit të rregulluar me Nenin 247, paragrafi 4 LFK dhe për shkak të nevojës për caktimin e kujdestarit të posaçëm të BUJARE FETAHUT për kontest, sipas Nenit 230, paragrafi 2 LFK, Gjykata Komunale e VITISË e pati kompetencën për t'ia caktuar asaj *përfaqësuesin e përkohshëm*, sipas Nenit 79, paragrafi 1 LPK, duke e njoftuar QPS- VITI, sipas Nenit 79, paragrafi 3 LPK lidhur me Nenin 265, paragrafi 2 LFK. Megjithatë, këto kompetenca nuk ishin shfrytëzuar nga Gjykata Komunale e VITISË – nuk është marrë asnjë Aktvendim për një caktim të tillë, sipas Nenit 387, paragrafi 1, pika q) LPK. Prandaj, në procedurë të shkallës së parë BUJARE FETAHU nuk pati përfaqësues të përkohshëm – kjo form e përfaqësimit ligjor të paraparë me Nenin 82, paragrafi 1 LPK nuk ishte shfrytëzuar për mbrojtjen e interesave të palës së mitur në këtë çështje gjyqësore që përfshinë të drejtën e bashkë-pronësisë së saj në këtë paluajtshmëri të kontestuar. *Së treti*, siç është theksuar më lartë, me 20 janar 2010 Gjykata Komunale e VITISË dërgoi një letër QPSc – VITI për të caktuar si Organ të Kujdestarisë një përfaqësues të së miturës të paditur BUJARE FETAHU për procedurë gjyqësore me që kujdestarja e saj FATIME FERAHU është bashkëshortja e paditësit FARI FETAHU dhe nuk mund ta përfaqësoj atë për shkak të konfliktit të interesit. Pa ndonjë përgjigje zyrtare, në seancat

gjqësore të 22 shkurtit, 26 marsit dhe 6 prillit 2010 MITAT MISINI nga QPS-VITI kishte marrë pjesë dhe ishte shënuar në procesverbal "*si përfaqësues i të paditurës BUJARE FETAHU*". Megjithatë, nuk ka ndonjë dokument që është depozituar në shkresat e lëndës që do të dëshmonte legjitimitetin procedural të sipërpërmendur në pajtim me Nenin 77, paragrafi 2, fjalë e parë LPK. Nuk ka ndonjë vendim të lëshuar nga Organi i Kujdestarisë të QPS- VITI bazuar në kompetencat sipas Nenit 232 lidhur me Nenin 6 LFK për caktimin e MITAT MISINIT si *kujdestar i veçantë* i BUJARE FETAHUT për lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË, sipas Nenit 230 LFK. Në këtë rast, ky Organ i Kujdestarisë nuk definoi në asnjë formë dhe në asnjë moment kufijtë e veprimit të autorizimit, të drejtat dhe obligimet e MITAT MISINIT për kujdestari të veçantë në vlerësimin e kontestit duke marrë parasysh rrethanat e lëndës, sipas Nenit 231, paragrafi 1 LFK. Pa këtë caktim individual ai nuk kishte të drejtë me elementet tjera normative të definuar për statusin e kujdestarit të veçantë- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë sipas Nenit 331, paragrafi 2 lidhur me Nenin 215, paragrafët 2 dhe 3 LFK. Lidhur me këtë, Neni 243, paragrafi 1 dhe Neni 266, paragrafi 1 LFK konstatojnë se vendimi i Organit të Kujdestarisë është detyrues për *caktimin e kujdestarit, duke përfshirë këtu edhe atë të veçantë*, sikurse edhe për besimin me *obligimet* e caktuara brenda vëllimit të autorizimit të dhënë - Neni 266, paragrafi 1 LFK. Si i tillë, akti i QPS – VITI nuk është dorëzuar në shkresat e lëndës, pra duhet të konkludohet se MITAT MISINI nuk është caktuar për kujdestar të veçantë të BUJARE FETAHUT për lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË. Ky mos-caktim e përjashton automatikisht edhe statusin e tij si përfaqësues ligjor, sipas Nenit 246, paragrafi 1 LFK sepse ky i dyti është dytësor në krahasim me të parin. Me që vendimi për caktimin e kujdestarit nga organi kompetent, sipas Nenit 6 LFK dhe Nenit 75, paragrafi 2 LPK është burim i përfaqësimit procedural ligjor, pa këtë akt të detyrueshëm, autorizimi që rezulton nga ai, nuk ishte themeluar në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË. Prandaj, në këtë lëndë pjesëmarrja e MITAT MISINI ishte vetëm *faktike* me që *ligjërisht* ai nuk kishte të drejtë ta përfaqësoj të miturën BUJARE FETAHU. Meqenëse një zotësi e përfaqësuesit ligjor e dhenë sipas rregullit është kusht për ligjshmërinë e të gjitha veprimeve procedurale të ndërmarra në emër të palëve (Neni 77, paragrafi 2 dhe Neni 78, paragrafi 2 LPK), veprimet e udhëhequra në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË nga MITAT MISINI për BUJARE FETAHU ishin të gjitha të paligjshme, pa efekt ligjor. Përmes tij kjo palë e mitur që nuk ka pas zotësi për të vepruar nuk ishte përfaqësuar në lëndë sepse pa vendimin e QPS-VITI për caktimin e tij si një *kujdestar i veçantë*, sipas Nenit 231 LFK, *zgjedhur ad hoc për këtë rast*, ai kur nuk e ka marrë statusin e përfaqësuesit ligjor të BUJARE FETAHUT siç është paraparë me Nenin 75, paragrafët 1 dhe 2 LPK dhe Neni 246, paragrafi 1 LFK. Kështu pjesëmarrja e MITAT MISINI në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË nuk neutralizoj mos-përfaqësimin e BUJARE FETAHUT me përfaqësues të emëruar sipas rregullit si një gabim procedural brenda Nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK. Gjykata e shkallës së parë vetëm *inicioi* procedurën për emërim, sipas Nenit 78, paragrafi 2 LPK dhe Nenit 265, paragrafi 2 LFK përmes letrës dërguar QPS-VITI me 20 janar 2010, por në

procedurë të mëvonshme nuk konsideroi atë si *detyrës zyrtare* sipas Nenit 76 LPK nëse është finalizuar me emërimin e kujdestarit të veçantë si një përfaqësues ligjor të zgjedhur *ad hoc* në këtë lëndë për të miturën BUJARE FETAHU. Udhëzimet përkatëse të dhënë në mënyrë të saktë me Aktvendimin AC.nr.76/2009 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 28 shtator 2009 nuk u zbatuan nga Gjykata e shkallës së parë pas rikthimit të lëndës në rigjykim. Në shkresat e lëndës, siç është theksuar në Aktvendimin AC.nr.76/2009 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 28 shtator 2009, përveç Vendimit Nr. 1038-2/04 të QPS –VITI, të datës 6 shtator 2004 për ndërprerjen e kujdestarisë së parë të MIRVETE SALIHU-FETAHUT dhe caktimi i FATIME FETAHUT për kujdestare, nuk ekziston ndonjë akt tjetër për kujdestari të veçantë ose masat tjera kujdestarie në lidhje me BUJARE FETAHUN. Në rigjykim të lëndës C.nr.350/09 Gjykata Komunale e VITISË edhe njëherë, saktësisht si në gjykimin e mëparshëm të lëndës C.nr.265/2008, nuk i përmbushi detyrat e saja sipas Nenit 76 LPK, të siguroj që kjo ndërgjyqëse e mitur ka një përfaqësues ligjor i caktuar sipas rregullit nga ana e QPS–VITI, të kërkoj nga MITAT MISINI të dëshmoj të drejtën e tij për këtë zotësi të përfaqësimit në lëndë, sipas Nenit 77, paragrafi 2 LPK ose të ndërmarrë të gjitha veprime tjera të nevojshme për një përfaqësim të drejtë për këtë palë cilës i mungon zotësia e plotë procedurale siç parashihet me Nenin 78, paragrafi 2 *in fine* LPK. Përderisa këto gabimet nuk janë korrigjuar, Gjykata Komunale e VITISË është dashtë të udhëheq vetëm veprimet *urgjente* procedurale për të cilat kishte rrezik për vonesë, sipas Nenit 78, paragrafi 3, fjalia e dytë LPK. Përkundër këtij kriteri, procedura gjyqësore e lëndës C.nr.350/09 ishte kompletuar plotësisht nga Gjykata Komunale e VITISË edhe pse përfaqësimi ligjor i të miturës BUJARE FETAHU nuk ishte përcaktuar sipas rregullit dhe evidentuar në lëndë. Së *tre*të, e njëjta i referohet mundësisë për *kujdestari të ushtruar drejtpërdrejt nga ana e organit të kujdestarisë*. Nuk ka ndonjë vendim i QPS–VITI të lëshuar në bazë të Nenit 240, paragrafi 1, fjalia e parë LFK të mos emërohet kujdestari por të përmbushet detyra e kujdestarisë drejtpërdrejt. Për më tepër, kjo zgjidhje do të ishte ligjërish e mundshme vetëm pas që caktimi i FATIME FETAHUT për kujdestare të BUJARE FETAHUT ka qenë e tërhequr përmes anulimit të Vendimit Nr.1038-2/04 të QPS–VITI, të datës 6 shtator 2004. Megjithatë, nuk ka një evidencë të tillë në shkresat e lëndës. Më tej, në mungesë të vendimit për kujdestari të ushtruar drejtpërdrejt nga ana e Organit të Kujdestarisë (Neni 240, paragrafi 1, fjalia e parë LFK), gjithashtu nuk ka vendim për emërimin e përfaqësuesit të Organit të Kujdestarisë për t'i udhëhequr detyrat e kujdestarit në emër të tij (Neni 240, paragrafi 1, fjalia e dytë LFK), sikurse edhe nuk ka vendim për delegimin e këtyre obligimeve tek profesionistët tjerë të cilët mund të veprojnë në emër të Organit dhe nën mbikëqyrjen e tij (Neni 242 LFK). Më në fund, QPS–VITI nuk e përfaqësoi BUJARE FETAHU përmes njërit nga përfaqësuesit e tij ose nga stafi tjetër meqenëse autorizimi, si akt i detyrueshëm për këtë përfaqësim sipas Nenit 246, paragrafi 2 LFK, kurrë nuk ka qenë prezantuar në këtë lëndë. Pa një akt të QPS- VITI për emërim të tillë individual, evidentuar sipas rregullit gjatë procedurës gjyqësore, bazuar në kriteret e Nenit 77, paragrafi 2 dhe Nenit 92, paragrafi 1 LPK, MITAT MISINI morri pjesë *de facto* në lëndën

C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË pa qenë *de jure* përfaqësues ligjor apo i autorizuar i këtij Organi të Kujdestarisë. Në asnjë fazë të procedurës ky person nuk e legjitimoi veten për sa i përket pozitës së tij në QPS-VITI, emërimin të tij si përfaqësues i Qendrës sipas nenit 240, paragrafi 1, fjalia e dytë LFK, delegimit të tij sipas Nenit 242 LFK dhe/ose autorizimit të tij sipas Nenit 246, paragrafi 2 LFK për të vepruar në këtë lëndë në emër të këtij Organi të Kujdestarisë. Asnjë nga këto kritere janë hequr nga ndonjë dispozitë të Ligjit Nr. 02/L-17 mbi Shërbimet Shoqërore dhe Familjare (Gazeta Zyrtare e IPV të Kosovës Nr. /2006) – përkundrazi, neni i këtij Ligji 7, paragrafi 2 konfirmon aplikimin e tyre duke përcaktuar se Organi i Kujdestarisë i themeluar me QPS përkatëse do të kryej detyrat e kërkuara me këtë punë siç është paraqitur në ligjet relevante të Kosovës - LFK dhe LPK. Duke përmbledhur këtë analizë, në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË e mitura BUJARE FETAHU nuk ishte përfaqësuar nga: 1) *një kujdestar i përgjithshëm* FATIME FETAHU sipas Nenit 236, paragrafi 1 LFK si përfaqësues ligjor sipas Nenit 246, paragrafi 1 LFK; 2) *një përfaqësues i përkohshëm* sipas nenit 79, paragrafi 1 LPK si përfaqësues ligjor sipas Nenit 82, paragrafi 1 LPK; 3) *një kujdestar i veçantë* sipas Nenit 230 LFK të emëruar për shkak të konfliktit të interesit siç paraparë me Nenin 247, paragrafi 4 LFK, si një përfaqësues *ad hoc* sipas Nenit 246, paragrafi 1 lidhur me Nenin 231, paragrafi 1 LFK; dhe/ose 4) *Organi i Kujdestarisë* me QPS-VITI si përfaqësues ligjor sipas nenit 6, paragrafi 2 LFK përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar sipas Nenit 246, paragrafi 2 LFK. Moshë madhore e arritur nga BUJARE FETAHU me 1 prill 2011 ka efekt ligjor *ex nunc* dhe nuk neutralizon *ex tunc*, në mënyrë retroaktive gabimet procedurale të sipërpërmendura e të bëra lidhur me përfaqësimin e saj në rigjykimin e shkallës së parë të përfunduar me 6 prill 2010, para datës së moshës madhore të saj. Për këto shkaqe, të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në emër të saj ose lidhur me të në këtë lëndë, mbesin të paligjshme. Kështu ligjërisht relevante për ekzaminimin ankimor mbetet fakti se kjo e mitur së cilës i mungonte zotësia e plotë procedurale për të vepruar në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË nuk pati përfaqësues ligjor apo të autorizuar me emërim të duhur dhe/ose autorizim të rregullt në këtë lëndë. Kjo paraqet shkelje të pasuese thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK, gjë që mjafton për aprovimin e ankesës.

23. Aktgjykimi i atakuar C.nr.350/09 i Gjykatës Komunale të VITISË, i datës 6 prill 2010 është marr me gabime të cilat nuk kanë mundur të ekzaminohen sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK. Në pjesën përmbledhëse, në diapozitivin dhe në arsyetimin, FARI FETAHU ishte përcaktuar si *paditës*, ndërsa MIRVETE SALIHU-FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU, ARIF FETAHU, ARTA FETAHU, ADELINA FETAHU dhe BUJARE FETAHU – si *të paditur*. Ky individualizim pasqyron vetëm zotësinë e tyre procedurale që lidhet me padinë dhe *anasjelltas* jo me *kundërpadinë* të ushtruar me 30 dhjetor 2008, ndonëse në këtë pjesë të dytë procedura gjyqësore nuk mund të konsiderohet e ndërprerë. *Së pari*, në shqyrtimin kryesor me 6 prill 2010 Avokati VISAR MUSA tërheqi kërkesëpadinë për sa i përket lirimit të pronës së kontestuar. Tërheqje e kundërpadisë sipas Nenit 261,

paragrafi 1 lidhur me Nenin 256, paragrafi 1 LPK nuk u deklarua apo u regjistrua në procesverbal. *Së dyti*, siç u theksua më lartë, caktimi i Avokatit VISAR MUSA si ofrues i ndihmës juridike për MIRVETE SALIHU-FETAHUN ishte i përkufizuar pëe Revizionin Rev.nr.156/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës. Prandaj, ai nuk ishte i autorizuar të bëjë asnjë lloj propozimesh procedurale në emër të saj në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË, duke përfshirë deklaratimet për tërheqje sipas Nenit 261, paragrafi 1 lidhur me Nenin 256, paragrafi 1 LPK. *Së treti*, si kundër- i paditur FARI FETAHU nuk e ka dhënë *pëlqimin* e tij me tërheqjen e kundërpadisë e as *saktësisht* nuk e bëri këtë sipas Nenit 261, paragrafi 2, fjalia e parë lidhur me Nenin 256, paragrafi 1 LPK, e as *në mënyrë të pashprehur* sipas Nenit 261, paragrafi 2, fjalia e dytë lidhur me Nenin 256, paragrafi 1 LPK. *Së katërti*, nuk është marr asnjë Aktvendim nga Gjykata Komunale e VITISË se kundërpadia është tërhequr sikurse që kërkohet me Nenin 261, paragrafi 3 lidhur me Nenin 256, paragrafi 1 LPK. *Së pesti*, kundërpadia është ushtruar me përmbajtje të pakuptueshme dhe jo të plotë, siç paraqitet në Nenin 253, paragrafi 1 lidhur me nenin 99, paragrafi 2 LPK. Megjithëse mangësitë janë identifikuar në mënyrë të saktë në Aktvendimin AC.nr.76/2009 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 28 shtator 2009, në lëndën C.nr.350/09 Gjykata Komunale të VITISË nuk dha ndonjë udhëzim për korrigjimin dhe plotësimin e kundërpadisë sipas Nenit 102, paragrafi 1 LPK. Si pasojë, ajo nuk mund të konsiderohet e tërhequr me që është e pakorrigjuar dhe e paplotësuar brenda afatit të paraparë bazuar në Nenin 102, paragrafi 3, fjalia e parë LPK, ose e refuzuar bazuar në Nenin 102, paragrafi 3, fjalia e dytë LPK. Prandaj, me Aktgjykimin e ankimuar *kontesti* i gjykuar dhe *zotësia procedurale e palëve* ishte përcaktuar vetëm pas *padisë*, ndonëse pjesë e *kundërpadisë*, procedura nuk u ndërpre – përkatësisht nuk ishte përjashtuar nga objekti i lëndës dhe palët ndërgjyqëse kishin ende statusin e kundërpaditësve – kundër- të paditurve që lidhen me të. Si rezultat i këtyre papërshtatshmërive procedurale, *kufijtë e vendimmarrjes* në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË janë të përmbledhur, sipas Nenit 2, paragrafi 1 LPK dhe të gjitha paditë e ushtruara nga palët ndërgjyqëse *nuk korrespondojnë* me *kufijtë e Aktgjykimit* në procedurë ankimore të definuar me dispozitivin e tij sipas Nenit 160, paragrafi 3 LPK.

24. Aktgjykimi C.nr.350/2009 i Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 6 prill 2010 përmban gabime tjera që përjashtojnë ekzaminimin e tij, sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK. Në veçanti, arsyetimi i tij sipas nenit 160, paragrafi 4 LPK përmban fakte lidhur me Kontratën e shitblerjes së pronës së paluajtshme të kontestuar dhe kontributin për blerjen e saj bazuar në deklaratat e DELI FETAHUT dhe KADRI FETAHUT të dhëna në procesverbalin e 24 dhjetorit 2002 dhe bazuar në deklaratën e ENVER REXHEPIT dhënë në procesverbalin e 21 qershorit 2005, megjithatë, pa ndonjë arsyetim dhe pa bazë se pse janë këtë deklarata konsideruar si *prova* të pranueshme. Gjykata e shkallës së parë nuk i përmbushi obligimet e saja sipas Nenit 8 LPK për të pranuar dhe konsideruar në rigjykim të lëndës C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË *vetëm provat e lejueshme me vlerë dëshmuuese në procedurë të veçantë gjyqësore*, sikurse edhe për të përjashtuar nga administrimi në

gjykim dhe nga ekzaminimi gjatë marrjes së Aktgjykimit të gjitha provat e siguruara në kundërshtim me dispozitat e procedurës kontestimore si të palejueshme. Për shkak të këtyre gabimeve, konstatimet faktike, vendimtare për zgjidhjen përfundimtare të kontestit, ishin themeluar mbi bazat e gabuara dëshmuese, të pavlerësuara sipas rregullit lidhur me lejueshmërinë e tyre. *Së pari*, DELI FETAHU, KADRI FETAHU dhe ENVER REXHEPI nuk ishin të ftuar në gjyq sipas Nenit 339, paragrafi 1 dhe Neni 346, paragrafi 1 LPK si *dëshmitarë* në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË për të dëshmuar në cilësinë e dëshmitarëve në këtë lëndë. At nuk ishin të informuar për të drejtat që të refuzojnë dëshmimin sipas Nenit 342, paragrafi 1 LPK dhe nuk ishin të njoftuar për të drejtat e tyre që të refuzojnë të përgjigjen në pyetjet e caktuara sipas Nenit 343 LPK brenda procedurës së veçantë gjyqësore. DELI FETAHU, KADRI FETAHU dhe ENVER REXHEPI nuk u paraqitën në asnjërën nga seancat gjyqësore publike të mbajtur lidhur me lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË me 22 shkurt 2010 dhe 26 mars 2010. Përkatësisht, asnjëra nga veprimet procedurale të paraparë ligjërisht për ekzaminimin e tyre sipas Nenit 347, paragrafi 1 LPK nuk ishin të udhëhequr në lëndën C.nr.350/09. Ata nuk ishin të informuar nga Gjykata e shkallës së parë për detyrën e tyre që të flasin të vërtetën pa lënë asgjë në heshtje dhe nuk iu është tërheq vërejtja për pasojat e dhënies së deklaratës së rreme në pajtim me Nenin 347, paragrafi 2, fjalia e parë LPK. Identiteti i tyre nuk është përcaktuar me shënimet personale të renditura në Nenin 347, paragrafi 2, fjalia e dytë LPK. DELI FETAHU, KADRI FETAHU dhe ENVER REXHEPI nuk ishin të marrë në pyetje në lëndën C.nr.350/2009 si dëshmitarë – *asnjërit prej tyre nuk iu janë parashtruar pyetjet gojarisht*, sipas Nenit 347, paragrafi 1, fjalia e dytë, *nga palët në procedurë dhe nga Gjykata sipas radhës siç është paraqitur në Nenin 348, paragrafët 1 - 2 LPK. Ata nuk ishin ballafaquar për dëshmitë kontradiktore, siç parashihet me Nenin 349 LPK, sikurse edhe nuk ishin ri-marrë në pyetje për sqarimin e provave të caktuara në pajtim me Nenin 350 LPK. Shkurtimisht, asnjëra nga kriteret të shtruar në Nenet 339 – 355 LPK që janë të detyrueshme për marrjen në pyetje të dëshmitarit në procedurë civile, nuk ishin përmbushur në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË lidhur me DELI FETAHUN, KADRI FETAHUN dhe ENVER REXHEPIN. Në shkelje të Nenit 425, paragrafi 1, pika d) LPK, ata nuk ishin marrë në pyetje gojarisht në shqyrtimin kryesor mbajtur me 6 prill 2010 dhe dëshmitë e tyre nuk ishin prezantuar drejtpërdrejt para Gjykatës së shkallës së parë siç kërkohet me Nenin 427 LPK. Rezultati i këtij mos-pëlqimi me këto kriteret të detyrueshme është se deklaratat e DELI FETAHUT, KADRI FETAHUT dhe ENVER REXHEPIT si dëshmitarë *nuk janë marrë si prova* në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË dhe *nuk mund të përdoren në marrjen e Aktgjykimit* në këtë lëndë. *Së dyti*, deklaratat e DELI FETAHUT dhe KADRI FETAHUT, dhënë me 24 dhjetor 2002, dhe ajo e ENVER REXHEPIT, dhënë me 21 qershor 2005, *me që janë të palejueshme*, është dashtë të përjashtohen nga Gjykata e shkallës së parë për sa i përket *mbledhjes* së atyre deklaratave gjatë procedurës në shqyrtimin kryesor sipas Nenit 425, paragrafi 1, pika e) LPK, sikurse edhe për sa i përket *marrjes së tyre në pyetje* sipas Nenit 8 LPK*

gjatë vendosjes lidhur me padi. Këto deklarata *nuk mund të cilësohen ligjërisht si deklaratat e dëshmitarëve* meqenëse ato nuk ishin të siguruara nga DELI FETAHU, KADRI FETAHU dhe ENVER REXHEPI pas dërgimit të ftesës për gjyq atë cilësi procedurale në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË dhe pas marrjes gojarisht në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejt gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur me 6 prill 2010, në kundërshtim me Nenin 427 LPK. Deklaratat e dëshmitarëve mund të janë vetëm të paraqitura gojarisht dhe duhet të merren në rast të veçantë në pajtim me kriteret e domosdoshme të Neneve 339–355 LPK. Për ndryshe ato nuk paraqesin dëshmi të dëshmitarëve dhe nuk mund të shërbejnë si provë sipas Nenit 319, paragrafi 2 LPK në procedurë civile. Për këto shkaqe, deklaratat e sipërpërmendura të DELI FETAHUT, KADRI FETAHUT dhe ENVER REXHEPIT ligjërisht nuk janë dëshmitë e dëshmitarëve dhe atyre iu mungon vlera përkatëse provuese. Duke qenë se janë *deklaratat me shkrim të personave të tretë, të cilët nuk janë palë në procedurë, ato paraqesin dokumente private pa efekt provues* – Neni 329, paragrafi 1 LPK. Faktet e përmendura në këto deklarata është dashtë të vërtetohen sipas rregullit në lëndën C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË meqenëse ato nuk kanë mundur të konsiderohen si të provuara në procedurat e mëparshme gjyqësore. Ky përjashtim sipas Nenit 321, paragrafi 1 LPK është i aplikueshëm vetëm për procedurat e përfunduara me *vendimet e plotfuqishme gjyqësore*, me që sipas këtij kriteri veprimet procedurale në të mbesin me efekte ligjore, duke përfshirë këtu edhe atë lidhur me vërtetimin e provave përkatëse. Në këtë hipotezë konkrete, përmes masave të jashtëzakonshme (revizionet), Aktgjykimi C.nr.118/2001 i Gjykatës Komunale të VITISË, i datës 24 dhjetor 2002 ishte anuluar me Aktvendimin Rev.nr.143/03 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 18 dhjetor 2003, ndërsa Aktgjykimin C.nr.16/2004 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 8 gusht 2005 ishte anuluar me Aktvendimin Rev.nr.159/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 20 maj 2008. Si pasojë, të gjitha veprimet procedurale në procedurë gjyqësore të përfunduar me këto Aktgjykimet e Gjykatës së shkallës së parë, duke përfshirë edhe ato veprime lidhur me mbledhjen e provave, ishin të shfuqizuara në mënyrë retroaktive. Kështu, marrja e në pyetje e DELI FETAHUT dhe KADRI FETAHUT si dëshmitarë në lëndën C.nr.118/01 të Gjykatës Komunale të VITISË me 24 dhjetor 2002, sikurse marrja në pyetje e ENVER REXHEPIT si dëshmitar në lëndën C.nr.16/2004 të Gjykatës Komunale të VITISË me 21 qershor 2005 ishin gjithashtu të shfuqizuara dhe që këtej dëshmitë e siguruara nëpërmes tyre janë *ex lege* e humbën vlerën provuese të tyre. Ato dëshmi nuk mund të shërbejnë si prova në asnjërën prej gjykimeve të mëpasshme për këtë padi dhe provat përkatëse duhej të vërtetohen përmes marrjes së re në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejt dhe gojore të DELI FETAHUT, KADRI FETAHUT dhe ENVER REXHEPIT në lëndën C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË sipas Nenit 319, paragrafi 1 LPK. Argumenti plotësues lidhur me këtë është mungesa e identitetit për sa i përket palëve ndërgjyqëse dhe përfaqësimit të tyre në lëndët C.nr.118/2001, C.nr.16/2004 dhe C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË– DELI dhe KADRI FETAHU dëshmuar në lëndën a parë me 24 dhjetor 2002 para se ARTA FETAHU, ADELINA

FETAHU, BUJARE FETAHU, HUMANE FETAHU, ARTON FETAHU dhe ARIF FETAHU të cilësohen si të paditur të ri plotësues, ndërsa ENVER REXHEPI dëshmoi në lëndën e dytë me 21 qershor 2005 në prezencë të MIRVETE SALIHUT si përfaqësuese ligjore e ARTA FETAHUT dhe ADELINA FETAHUT, ndonëse kujdestaria e saj për ata fëmijë ishte ndërpreë me 6 shtator 2004. Për shkak të mospjesëmarrjes ose përfaqësimit të paligjshëm këto deklarata nuk kanë efekt ligjor, detyruese për të gjithë palët ndërgjyqëse në lëndën C.nr.350/09. Përkundër këtyre të metave procedurale, gjatë marrjes së Aktgjykimit në procedurë ankimore, ato deklarata nuk ishin të përjashtuar nga ekzaminimi si të palejuara por janë marrë parasysh si element të bazës provuese. Këto mospërputhje ndërmjet asaj se çka është theksuar në arsyetimin e Aktgjykimit për përmbajtjen e procesverbalit me këto deklarata dhe përmbajtjen e tyre aktuale me që mungesa e vlerës provuese të këtyre dokumenteve janë shkeljet procedurale sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK.

25. Në kundërshtim me Nenin 160, paragrafi 4 LPK dhe Rev.nr.143/03 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 18 dhjetor 2003, thënia lidhur me bazat e Aktgjykimit C.nr.350/2009 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 6 prill 2010 *nuk jep arsyetimin për faktet vendimtare materiale për kontestin pronësor të gjykuar siç është regjistrimi kadastral të ngastrës së kontestuar në emër të të ndjerit ARIF FETAHUT dhe/ose të bashkë-trashëgimtarëve të tij dhe bazës së saj ligjore. Kjo mangësi e Aktgjykimit në procedurë ankimore është e metë tjetër procedurale brenda Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK.*

26. Bazuar në analizat e përmendura më lartë dhe brenda kufijve të procedurës ankimore sipas Nenit 194 LPK, Gjykata e shkallës së dytë përfundoi se ekzistojnë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pikat k) dhe n) LPK, të theksuara në ankesë dhe të ekzaminuara *sipas detyrës zyrtare*. Esenca e tyre, me që ndikon në marrjen e Aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, është e konsideruar në mënyrë normative dhe anulimi i Aktgjykimit të ankimuar është i arsyetuar mbi këto baza procedurale sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike - Neni 183 LPK

27. Siç është theksuar më lartë gjendja faktike në këtë kontekst ishte vërtetuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë mbi bazat e provave të grumbulluara me shkelje procedurale duke përjashtuar lejueshmërinë e tyre dhe vlerën provuese. Kjo në vete *shkel korrektësinë e konstatimeve faktike si të vërtetuara padrejtësisht*. Më tej, Gjykata e shkallës së parë *dështoi në themelimin e fakteve bindëse për padi*, siç janë regjistrimi kadastral i ngastrës së kontestuar, ekzistimi/mos-ekzistimi i bashkësisë familjare në momentin e blerjes së saj, sikurse edhe pjesëmarrja/mos-pjesëmarrja e anëtarëve të kësaj bashkësie në blerjen e kësaj prone të paluajtshme si rponë e përbashkët. Shprehur shkurtimisht, të gjitha këto dëshmojnë se për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas Nenit 183 LPK.

Zbatimi i gabuari i së drejtës materiale - Neni 184 LPK

28. Në Aktgjykimin C.nr.350/09 të Gjykatës Komunale të VITISË, të datës 6 prill 2010 nuk janë theksuar *dispozitat e së drejtës materiale* siç aplikohet në vendosjen e pretendimeve të palëve bazuar në kriteret e kërkuara në mënyrë të domosdoshme me Nenin 160, paragrafi 5, fjalía e parë LPK. Domethënë, Nenet 326 – 331 LMMF lidhur me *marrëdhëniet pronësore të anëtarëve të bashkësisë familjare* në 1995, viti i blerjes së ngastrës kontestuese, dhe Neni 18 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronëso- Juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ, Nr. 6/1980) nuk ishin cituar Aktgjykimin e ankimuar në asnjë kontekst. Ky dështim për implementimin e këtyre Neneve paraqet zbatimin e gabuar të së drejtës materiale sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika c) LPK në hipotezën e parë të definicionit ligjor sipas Nenit 184 LCP.

VI. Konkluzion

29. Bazuar në arsyet e sipërpërmendura Gjykata e shkallës së dytë do të aprovoj ankesën e FARI FETAHUT – Aktgjykimi C.nr.350/2009 i Gjykatës Komunale të VITISË, i datës 6 prill 2010 do të anulohet sipas Nenit 195, paragrafi 1, pika c) LPK me që i marrë në mënyrë të paligjshme me arsyet për kundërshtimin e tij, sipas Nenit 181, paragrafi 1, pikat a) – c) LPK, në çka është thirr në ankesë dhe ato të identifikuar *sipas detyrës zyrtare* gjatë ekzaminimit ankimor. Lënda do t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim të rregullt procedural sipas Nenit 198, paragrafi 2 LPK.

Duke marrë parasysh arsyetimin e sipërpërmendur është vendosur si në diapozitiv.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa

GJYKATA E QARKUT E GJILANIT

AC. nr.195/2010 me 30.06.2011

KRYETARE E TRUPIT GJYKUES




ROSITZA BUZOVA

Republika e Kosovës
Kryedlloga

PARTI DINKU
TAGRUST DEDRAGU

Prokuror i shtetit
Kryedlloga

**Përkthyer nga anglishtja ne shqip nga:
Xhangyle Ilijazi, perkthyes ne EULEX,**



Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.